



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 208, dt.25.09.2015

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, bazuar dhe në rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 25.09.2015, pasi shqyrtoi kërkesën për licensim në fushën e restaurimit për *ing. Fatjon Saliu*,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën për pajisje me licensë restaurimi personale profesionale në fushën e restaurimeve për kategorinë **AZ. “Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës”**, me nënkategoritë **AZ/3, AZ/4**, sipas rregullore “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit” të *ing. Fatjon Saliu*.
 2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, pajisjen e *ing. Fatjon Saliu* me licensë restaurimi personale profesionale në fushën e restaurimeve për kategorinë **AZ. “Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës”**, me nënkategoritë **AZ/3, AZ/4**.
 3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

